



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA JURIDIKE DHE E PËRPUTHSHMËRISË SË STANDARDEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë më ____ . ____ .2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

13.06.2022

Drejtuar: Operatorit Ekonomik **“GJIKURIA” SHPK**

Tirane Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Ibrahim Rugova, Prane Gardes se
Republikes, Pallati Kontakt, mbi Union Bank

Procedura e prokurimit/lotit: **“E Hapur - Mbi kufirin e lartë Monetar - Punë - prokurim
me mjete elektronike”**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-24715-04-11-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i aksit rrugor Maliq-Lozhan i Ri-
Strelcë”**

**Fondi limit: 1.183.260.667,94 (një miliard e njëqind e tetëdhjetë e tre milion e dyqind e
gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë presje nëntëdhjetë e katër) Lekë
pa TVSH / 9.767.712,30 EUR pa TVSH (kursi i këmbimit, 1 (një) Euro këmbëhet me
121.14 Lekë)**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 24 muaj

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):

Buletini i Njoftimeve Publike: **Data 19 Prill 2022, Nr. 50**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE “ARIFAJ” SHPK & EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI

J76418907K / K91727010A

Vlera: **1.055.530.088** (një miliard e pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tridhjetë mijë e tetëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh.

2. BOE “S I R E T A 2F” & “KUPA” SHPK & “KLAJGER KONSTRUKSION” SHPK

K51501008J / K51615512C / K51423028P

Vlera: **1.111.111.111** (një miliard e njëqind e njëmbëdhjetë milion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.

3. “PE - VLA - KU” SHPK

K61716013M

Vlera: **1.123.818.390,45** (një miliard e njëqind e njëzet e tre milion e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë presje dyzet e pesë) lekë pa tvsh.

4. BOE “BE - IS” SHPK & “ERGI” SHPK & “VELLEZERIT HYSA” SHPK

K71412003A / K02727229P / K12911201C

Vlera: **1.137.311.585** (një miliard e njëqind e tridhjetë e shtatë milion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

5. “GJIKURIA” SHPK

J62903456H

Vlera: **1.164.381.419,30** (një miliard e njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë presje tridhjetë) lekë pa tvsh.

6. “G.P.G. COMPANY” SHPK

J64324443V

Vlera: **1.180.469.390,10** (një miliard e njëqind e tetëdhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e treqind e nëntëdhjetë presje dhjetë) lekë pa tvsh.

7. “ALBAVIA” SHPK

J81527001Q

Vlera: **1.181.717.486** (një miliard e njëqind e tetëdhjetë e një milion e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE “ARIFAJ” SHPK & EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI
J76418907K / K91727010A
2. BOE “S I R E T A 2F” & “KUPA” SHPK & “KLAJGER KONSTRUKSION” SHPK
K51501008J / K51615512C / K51423028P
3. “PE - VLA - KU” SHPK K61716013M
4. “G.P.G. COMPANY” SHPK J64324443V
5. “ALBAVIA” SHPK J81527001Q

Arsyet e skualifikimit si më poshtë:

1. Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ARIFAJ” SHPK & EUROKOS HOLDING SH.P.K, pasi nuk ka arritur të paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithë kriterëve te kerkuara ne DST, konkretisht;

Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë personelin kryesor dhe mbështetës, drejtues teknik në licencën e shoqërisë sipas përcaktimeve në DST.

Nga Operatori Ekonomik stafi teknik dhe profesional i deklaruar i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate (konkretisht, drejtuesi i projektit) në këtë procedurë prokurimi është i deklaruar në një objekt tjetër në proces ndërtimi pranë Autoritetit Kontraktor.

Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme sipas përcaktimeve në DST.

Nga Operatori Ekonomik në deklaratën e paraqitur për disponimin e mjeteve / pajisjeve / makinerive të nevojshme për realizimin e këtij objekti, disa nga makineritë janë të deklaruara në një objekt tjetër në proces ndërtimi pranë Autoritetit Kontraktor. Bazuar në Dokumentat Standarde të Tenderit dhe në Deklaratën e Operatorit **makineritë e Operatorit nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues*”.

2. Skualifikohet bashkimi i operatorëve ekonomikë “S I R E T A 2F” & “KUPA” SHPK & “KLAJGER KONSTRUKSION” SHPK, pasi nuk ka arritur të paraqesin dokumentacion të saktë dhe të plotë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të përcaktuara në DST, konkretisht:

- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Puna e ngjashme e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk plotëson përqindjen pjesëmarrëse të secilit në këtë bashkim operatorësh.

3. Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “PE - VLA - KU” SHPK, pasi nuk ka arritur të paraqese dokumentacion të plote dhe të sakte për të deshmuar plotesimin e të gjithë kritereve të kerkuara ne DST, konkretisht:

1.Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).

4. Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “ALBAVIA” SHPK, pasi nuk ka arritur të paraqese dokumentacion të plote dhe të sakte për të deshmuar plotesimin e të gjithë kritereve të kerkuara ne DST, konkretisht:

Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë personelin kryesor dhe mbështetës, drejtues teknik në licencën e shoqërisë sipas përcaktimeve në DST.

Stafi teknik dhe profesional i deklaruar i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate në këtë procedurë prokurimi janë të deklaruar në një objekt tjetër në proces ndërtimi pranë Autoritetit Kontraktor.

Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme sipas përcaktimeve në DST.

Nga Operatori Ekonomik në deklaratën e paraqitur për disponimin e mjeteve / pajisjeve / makinerive të nevojshme për realizimin e këtij objekti disa nga makineritë janë të deklaruar

në një objekt tjetër në proces ndërtimi pranë Autoritetit Kontraktor. Bazuar në Dokumentat Standarde të Tenderit dhe në Deklaratën e Operatorit **makineritë e Operatorit nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues**.

5. Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “G.P.G. COMPANY” SHPK pasi nuk ka arritur të paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithë kriterëve te kerkuara ne DST, konkretisht:

Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë personelin kryesor dhe mbështetës, drejtues teknik në licencën e shoqërisë sipas përcaktimeve në DST. Stafi teknik dhe profesional i deklaruar i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate në këtë procedurë prokurimi janë të deklaruar në një objekt tjetër në proces ndërtimi pranë Autoritetit Kontraktor.

Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme sipas përcaktimeve në DST.

Nga Operatori Ekonomik në deklaratën e paraqitur për disponimin e mjeteve / pajisjeve / makinerive të nevojshme për realizimin e këtij objekti disa nga makineritë janë të deklaruar në një objekt tjetër në proces ndërtimi pranë Autoritetit Kontraktor. Bazuar në Dokumentat Standarde të Tenderit, dhe në Deklaratën e Operatorit **makineritë e Operatorit nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues**.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“GJIKURIA” SHPK**, me adresë: Tirane Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Ibrahim Rugova, Prane Gardes se Republikes, Pallati Kontakt, mbi Union Bank, me NUIS: **J62903456H**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **1.164.381.419,30 (një miliard e njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë presje tridhjetë) lekë pa tvsh / totali i pikëve të marra sipas sistemit [253.50]**, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Evis Berberi